

Të Nderuar Qytetarë,

Për çdo shqetësim Tuajin, për të cilin Ju keni nevojë të merrni një përgjigje, ne Ju ofrojmë një mënyrë komunikimi më të shpejtë e më efikase, se letrat e shkruara me dorë, të cilat kalojnë nëpër hapa, që mund të vonojnë përgjigjen tonë, duke llogaritur këtu dhe kohën që nevojitet për shkëmbimin e pyetje-përgjigjeve në rrugë postare. Për t'Ju ofruar mundësinë që të merrni një përgjigje, në një kohë prej 10 ditë pune, Ju ftojmë të regjistroheni në platformën:

"Shqipëria që duam"

www.shqiperiaqeduam.al

"Shqipëria që duam" është një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi, e cila do të shërbejë për t'Ju dëgjuar në kohë reale, për çështje të aktualitetit politik e qeverisë; për të diskutuar me Ju, reforma e masa të rëndësishme, duke mundësuar ndikimin Tuaj mbi politikat qeverisëse, në çdo sektor apo mbi ecurinë e punës, së çdo ministrie e institucioni shtetëror. Kjo platformë është një instrument praktik i bashkëqeverisjes me çdo njeri të zakonshëm, që dëshiron të jetë pjesë e përpjekjes për Shqipërinë që duam.

Për regjistrim mund të ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Ne Google shkruani: <https://www.shqiperiaqeduam.al/>

E cila do t'ju drejtojë tek:

<https://e-albania.al/mobile/regjistrohuni.aspx?ref=shqdapp>

2. Vendosni Kodin e paraqitur dhe vazhdoni më tej.
3. Në faqen pasardhëse vendosni NID (Numri personal) dhe të dhënat tuaja si ju kërkohen.
 - Kodi i përdoruesit (Numri personal NID):
 - Fjalëkalimi (Minimumi 7 karaktere):
 - Fjalëkalimi përsëri:
 - E-mail:
 - Nr. Celular (Formati 06xxxxxxxx):
 - Pyetja e sigurisë:
 - Të dhënat e përdoruesit: ku përfshihen: Emri:, Atësia:, Mbiemri: Datëlindja
4. Pas miratimit të të dhënave tuaja personale shtypni "Regjistrohu".
5. Kodin që do t'ju vijë me SMS në celularin tuaj, vendoseni në fushën e regjistrimit.

Tashmë, Ju jeni regjistruar dhe jeni pjesë e platformës "Shqipëria që duam".

Më pas logohuni në <https://www.shqiperiaqeduam.al/> dhe shprehni mendimin tuaj në çdo rubrikë të Platformës si: Ankesa Ime, Nisma Ime, Fjala Ime, Interpelanca Ime, Nota Ime, Shkolla Ime, Biznesi Im, Kuvendimi Ynë, Dua Të kontribuoj, Historia Ime.

Ne jemi aty për t'Ju dhënë përgjigje brenda kohës së përcaktuar.

Shënim: Në platformë mund të regjistroheni dhe të logoheni edhe duke përdorur një aplikacion nga telefoni juaj "Android" ose "iPhone" të cilin mund ta shkarkoni në "APP ose PLAY store" duke kërkuar: "Për Shqipërinë që Duam"

Ju Mirëpresim,

Zyra e Bashkëqeverisjes
Agjencia për Dialog e Bashkëqeverisje